

29.01.2014 – Njoftim për shtyp

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele e Republikës së Maqedonisë në seancën e 4-ët e cila u mbajt me datë 28.01.2014, e miratoi konceptin për monitorimin e serviseve programore të radiove dhe televizioneve dhe Metodologjinë për monitorimin e paraqitjes mediave gjatë zgjedhjeve nëpërmjet serviseve programore televizive gjatë procesit zgjedhor.

Koncepti i vërteton periudhat e monitorimit (që nga shpallja e zgjedhjeve, raundi i parë dhe i dytë i fushatës zgjedhore dhe heshtje zgjedhore), përfshirja e mediave, mostra e programit të tyre që do të jetë lëndë e analizës dhe mënyra e realizimit dhe numri i bashkëpunëtorëve të jashtëm për realizimin e monitorimit.

Sqarimeve i metodologjisë në detaje se si do të bëhet monitorimi i të gjitha obligimeve ligjore lidhur me informimin e mediave. Metodologjia jep pasqyrim relevant të masës ligjore, i vërteton qëllimet e monitorimit, lëndën dhe metodën e monitorimit. Në kuadër të metodës, është definuar se cilat aspekte kualitative dhe kuantitative duhet që të realizohen në programet ditore informative dhe në çfarë mënyre, pastaj cilat pyetje të programeve të veçanta informative janë të rëndësishme (intervista, debate, RA/TV takime e të ngjashme), ç'far do të monitorohet në format e qasjes së drejtpërdrejtë të publikut/votuesit (paraqitje politike pa pagesë dhe reklamim i paguar politik) dhe ç'far do llogaritet për shkelje të heshtjes zgjedhore.

Komplet tekstin e Konceptit dhe Metodologjisë mund ta merrni në ballinën e ueb – faqes së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Në seancën e 5-të, e mbajtur me datë 29.01.2014, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për mos respektimin e obligimit për transmetimin e muzikës vokale dhe/ose vokale instrumentale, në pajtueshmëri me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ju shqiptoj masa vërejtje: RA Ros Metropolis, Servisi i parë programor të Televizionit Maqedonas, Servisi i dytë programor i Televizionit Maqedonas, TV Alfa, TV Telma, TV Kanal5, TV Alsat – M dhe TV Sitel.

Masat e marra me shpjegim të detajuar janë të publikuara në ueb – faqen e Agjencisë.

Agjencia e miratoi projektin programin për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele të RM-ës në vitin 2014 (Program për aktivitetet e planifikuara) dhe në pajtueshmëri me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, hap debat publik dhe i fton të gjithë anët e interesuara, në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të tyre, që ti shprehin mendimet e tyre, pamjet dhe qëndrimet. Teksti për projektin programin është i publikuar në ueb – faqen e Agjencisë.